



UDHËRRËFYES PËR STATUTET KOMUNALE

Dhjetor 2007

PËRMBAJTJA

PARATHËNIE	- 3 -
KAPITULLI I. KORNIZA PËR QEVERISJEN LOKALE.....	- 4 -
1.1 INSTRUMENTET NDËRKOMBËTARE	- 4 -
1.2 INSTRUMENTET VENDORE	- 5 -
KAPITULLI II. PARIMET UDHËHEQËSE.....	- 8 -
2.1 REFLEKTIMI I VLERAVE DHE KARAKTERISTIKAVE TË KOMUNITETIT	- 8 -
2.2 PJESËMARRJA E PUBLIKUT DHE KONSULTIMET	- 9 -
2.2.1 <i>Baza ligjore për konsultimet publike dhe pjesëmarrjen</i>	- 9 -
2.2.2 <i>Dëgjimet publike, aktivitetet jashtë zyrës dhe grupet e interesit</i>	- 10 -
2.2.3 <i>Takimet publike vjetore</i>	- 11 -
2.2.4 <i>Takimet e Kuvendit komunal dhe të Komiteteve</i>	- 11 -
2.2.5 <i>Situatat që arsyetojnë përjashtimin e publikut nga takimet e komunës</i>	- 12 -
2.2.6 <i>Peticionet</i>	- 12 -
KAPITULLI III. STRUKTURA E QEVERISË LOKALE	- 14 -
3.1 DEGA EKZEKUTIVE	- 14 -
3.1.1 <i>Kryetari i Komunës</i>	- 14 -
3.1.2 <i>Bordi i Drejtorëve dhe departamentet komunale</i>	- 16 -
3.2 DEGA LEGJISLATIVE	- 17 -
3.2.1 <i>Kuvendi Komunal</i>	- 17 -
3.2.1.1 <i>Komitetet e Kuvendit Komunal</i>	- 19 -
3.2.1.2 <i>Komitetet e detyrueshme</i>	- 20 -
3.2.1.2.3 <i>Komiteti për Komunitete dhe Komiteti për Ndërmjetësim</i>	- 21 -
3.2.1.2.4 <i>Komiteti për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale</i>	- 24 -
3.2.1.2.5 <i>Komiteti për Edukim e Kulturë</i>	- 24 -
3.2.1.2.6 <i>Komiteti për Zhvillim Ekonomik</i>	- 25 -
3.2.1.2.7 <i>Komiteti për Planifikim Urban, Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit</i>	- 25 -
3.2.1.3 <i>Komitetet shitesë</i>	- 26 -
3.3 MARRËDHËNIET NË MES TË DEGËVE TË QEVERISË.....	28
KAPITULLI IV. NËN-NIVELET KOMUNALE	30
4.1 NËN-NIVELET KOMUNALE	30
4.2 DE-KONCENTRIMI I AUTORITETIT KOMUNAL	30
LISTA KONTROLLUESE – PËR GRUPIN PUNUES TË STATUTEVE KOMUNALE.....	32
ANEKSET	34
ANEKSI 1: KARTA EVROPIANE PËR VETËQEVERISJEN LOKALE.....	35
ANEKSI 2: RREGULLORJA E UNMIK-UT 2007/30.....	36
ANEKSI 3: UDHËZIMI ADMINISTRATIV I UNMIK-UT 2003/002 PËR KOMITETET E KOMUNITETEVE	37
ANEKSI 4: UDHËZIMI ADMINISTRATIV I MINISTRISË SË ADMINISTRIMIT TË PUSHTETIT LOKAL 2005/001 PËR KOMITETIN PËR NDËRMJETËSIM	38

Parathënie

Ky Udhërrëfyes për Statutet Komunale (tash e tutje: Udhërrëfyes) ka për qëllim t'u ndihmojë komunave në Kosovë në hartimin e Statuteve Komunale.

Statutet Komunale (në vijim "Statutet") janë bërë për herë të parë më 2000 nga Kuvendet Komunale pas shpalljes së Rregullores së UNMIK-ut 2000/45 për Vetëqeverisjen e Komunave në Kosovë (në vijim "Rregullorja e UNMIK-ut 2000/45"). Statutet janë shkruar në linjë me Modelin e Statutit Komunal që është hartuar nga përfaqësuesit prej Shtyllës II të UNMIK-ut (Administrimit Civil të Kombeve të Bashkuara në Kosovë) dhe të Shtyllës III (Misionit të OSBE-së në Kosovë) si dhe nga përfaqësuesi i Këshillit të Evropës.

Në tetor 2007, është nxjerrë korniza e re legjislative për qeverinë lokale. Rregullorja e UNMIK-ut 2007/30 me të cilën ndryshohet Rregullorja e UNMIK-ut 2000/45 për Vetëqeverisjen e Komunave në Kosovë (në vijim "Rregullorja e UNMIK-ut 2007/30") dhe Rregullorja e UNMIK-ut 2007/27 për Zgjedhjet komunale në Kosovë kanë ndryshuar skemën institucionale të vetëqeverisjes lokale. Pas zgjedhjeve të 17 nëntorit 2007, komunat do të duhet të bëjnë përshtatjen e Statuteve të tyre në përputhje me këto ndryshime. Ky Udhërrëfyes është përpiluar për t'u ndihmuar komunave në rihartimin e Statuteve të tyre.

Kapitulli I i këtij Udhërrëfyesi diskuton instrumentet kryesore ndërkombëtare e vendore që shërbejnë për orientimin, përkatësisht rregullimin e qeverisjes lokale në Kosovë. Kapitulli II ofron një shtjellim të parimeve drejtuese kryesore të Statutit: nevoja që Statutet të jenë në pajtim me kornizën ligjore për qeverisjen lokale, aty përshkruhet pse dhe si duhet Statuti të pasqyrojë karakteristikat e komunitetit, si dhe rëndësinë e përfshirjes së neneve për pjesëmarrjen e publikut në statute. Këtu theksohet rëndësia e takimeve publike dhe e pjesëmarrjes civile, si dhe prezantohen instrumente tjera të pjesëmarrjes siç është peticioni. Kapitulli III shpjegon mënyrën si Statutet duhet të pasqyrojnë strukturën e qeverisjes lokale. Më tej aty shtjellohet dega ekzekutive e komunës. Vëmendje e posaçme i kushtohet rolit të Kryetari të Komunës si kryesues i Kuvendit Komunal dhe Bordit të Drejtorëve. Gjithashtu, këtu diskutohet për rolin e organeve legjislative në Statute, dhe theks i veçantë i kushtohet rolit të Komitetit të Komuniteteve. Kapitulli III adreson gjithashtu marrëdhënien në mes të autoritetit ekzekutiv dhe administratës. Format e mundshme të bashkëpunimit me nën-nivelet komunale sikur që janë fshatrat, vendbanimet apo lagjet urbane, janë adresuar në Kapitullin IV.

Udhërrëfyesi përmbyllë secilin Kapitull të tij me një listë rekomandimesh, p.sh. që Kuvendet Komunale të themelojnë grupin punues të përkohshëm për hartimin e Statuteve të tyre përkatëse të ardhshme. Përbërja e propozuar e komitetit rekomandohet të jetë me sa vijon: anëtarët e Kuvendit Komunal, Kryetari i Komunës, Zyrtari ligjor i komunës, si dhe anëtarët nga shoqëria civile.

Udhërrëfyesi është hartuar nga Misioni i OSBE-së në Kosovë, në bashkëpunim të ngushtë me Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal.

Kapitulli I. Korniza për qeverisjen lokale

1.1 Instrumentet ndërkombëtare

Karta Evropiane për Vetëqeverisjen Lokale (në vijim “Karta”) siguron parimet drejtuese për rekomandimet e këtij Udhërrefyesi. Ky Kapitull përshkruan sfondin, rolin dhe përmbajtjen e Kartës.

Karta është miratuar në formë të Konventës nga Komiteti i Ministrave të Këshillit të Evropës (shih Aneksin 1) dhe është hapur për nënshkrim nga vendet anëtare të Këshillit të Evropës, më 15 tetor 1985.¹ Ajo përshkruan parimet bazë për vetëqeverisjen lokale dhe shërben si referencë për kornizën ligjore për vetëqeverisje lokale në të gjitha vendet anëtare të Këshillit të Evropës.

Karta përcakton që parimi i vetëqeverisjes lokale do të njihet në legjislacionin e vendit dhe kur është e zbatueshme edhe në kushtetutë.² Koncepti i vetëqeverisjes lokale, i theksuar në Nenin 3 të Kartës, përfshin të drejtën dhe aftësinë e autoriteteve lokale, brenda kufizimeve të ligjit, për rregullim dhe menaxhim të një pjese të konsiderueshme të çështjeve publike nën përgjegjësinë e tyre dhe në interes të popullatës lokale. Preambula e Rregullores së UNMIK-ut 2007/30 i referohet shprehimisht Kartës, veçmas në Nenin 3. Prandaj, Karta, nga komunat, duhet te përdoret si model i cili paraqet standardet Evropiane të cilat duhet të përfillen në Kosovë.

Neni 3 vazhdon me përshkrimin e kompetencave “vetanake”. Në nenin 4, paragrafi 5 të Kartës përshkruhen kompetencat e “deleguara”. Kompetencat e deleguara u lejojnë autoritetet lokale, kur kompetencat u janë deleguar atyre nga autoritetet qendrore apo rajonale, liri veprimi në përshatjen e veprimeve të tyre me rrethanat lokale.

Shtirja e vetëqeverisjes lokale është përshkruar në Nenin 4 të Kartës. Paragrafi 3 i këtij Neni kërkon që “përgjegjësitë publike të ushtrohen përgjithësisht, sipas preferencës, nga ato autoritete që janë më së afërmi me qytetarin. Caktimi i përgjegjësisë një autoriteti tjetër duhet të marrë parasysh shtirjen dhe natyrën e detyrës dhe kërkesat për efikasitet dhe ekonomizim”. Ky parim ndryshe njihet edhe si parimi i subsidiaritetit.

Marrë parasysh rëndësinë e parimit të subsidiaritetit, Komiteti i Ministrave të Këshillit të Evropës ka miratuar Rekomandimin Nr. R(95) 19 për implementim të parimit të subsidiaritetit.³ Aty u rekomandohet qeverive të vendeve anëtare, *inter alia*, që të “[...] specifikojnë në legjislacionin relevant, tërësinë themelore të kompetencave që i takojnë secilit nivel të autoriteteve lokale e rajonale, veç marrjes së kompetencës së përgjithshme; që të themelojnë procedurat apo mekanizmat, të natyrës ligjore apo politike, në rastet kur këto tashmë nuk ekzistojnë, për të përkrahur implementimin e parimit të subsidiaritetit dhe për

¹ Karta Evropiane për Vetëqeverisjen Lokale është nënshkruar dhe ratifikuar nga 43 prej 47 vendeve anëtare të Këshillit të Evropës.

² Neni 2 i Kartës.

³ Miratuar nga Komiteti i Ministrave më 12 tetor 1995.

trajtuar ndonjë debat të mundur lidhur me të; për zbatimin e të gjitha këtyre dispozitave jo vetëm për marrëdhëniet në mes të qeverisë qendrore dhe autoriteteve lokale, [...]”⁴

Së këndejmi, autoritetet e Kosovës duhet të kenë parasysh parimet e Kartës gjatë themelimit të Statuteve të reja: “Kompetencat dhe përgjegjësitë bazë të autoriteteve lokale përshkruhen me kushtetutë apo me statut. Megjithatë, kjo dispozitë nuk pengon veshjen e autoriteteve lokale me kompetenca dhe përgjegjësi për qëllimet specifike, në pajtim me ligjin”⁵.

1.2 Instrumentet vendore

Statutet Komunale duhet të jenë në përputhje me kornizën ligjore për qeveritë lokale në Kosovë. Ky seksion bën përshkrimin e asaj kornize ligjore. Korniza e tanishme ligjore për komunat në Kosovë ka një hierarki specifike.

Rregullorja e UNMIK-ut 2007/30 i referohet Kartës, veçmas Nenit 3 që shënon të drejtën dhe aftësinë e autoriteteve lokale, brenda kufizimeve të ligjit, për rregullim dhe menaxhim të një pjese të konsiderueshme të çështjeve publike nën përgjegjësinë e tyre dhe në interes të popullatës lokale. Karta deklaron që “autoritetet lokale janë një nga themelet kryesore të çdo regjimi demokratik” dhe duhet të sigurojnë një administratë që është efektive dhe e afërt me qytetarin.

Rregullorja e UNMIK-ut 2007/30 dhe Rregulloret tjera relevante të UNMIK-ut bëjnë definimin e funksioneve dhe përgjegjësi të përgjithshme që janë bartur në komunat.⁶ Rregulloret e UNMIK-ut që kanë bazën e tyre ligjore në Rezolutën 1244 të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara të datës 10 qershor 1999 dhe në Rregulloren e UNMIK-ut 1999/1 për Autoritetin e Administratës së Përkohshme në Kosovë, rangohen si aktet më të larta legjislative në Kosovë. Çdo ligj i aprovuar nga Kuvendi i Kosovës duhet të jetë në pajtim me Rregulloret e nxjerra nga UNMIK-u.

Statuti do të rregullojë implementimin e përgjegjësi të komunës së themeluar⁷. Statuti është akti më i lartë normativ i komunës. Ai përcakton organizimin intern të komunës duke marrë parasysh karakteristikat e komuniteteve të saj, kulturën, interesat ekonomike, përbërjen linguistike e sociale, si dhe prioritetet dhe resurset e tyre specifike. Statuti miratohet nga Kuvendi Komunal dhe rregullon implementimin e përgjegjësi dhe të aranzhimeve politike të komunës⁸.

Rregullat e procedurës mundësojnë menaxhim efikas dhe kontroll, përfshirë këtu kontrollin financiar të administratës së komunës⁹. Kuvendi Komunal nxjerr Rregullat e Procedurës për adresimin e çështjeve teknike të punës së seancave plenare dhe të komiteteve. Për shembull, duhet të përmbajë dispozita për përgatitjen dhe publikimin e agjendës, procedurën e regjistrimit të mocioneve dhe aplikacioneve, si dhe për distribuim të punës nëpër komitete.

⁴ Për informata më të hollësishme, shih faqen 2 të Rekomandimit Nr. R (95) 19 të Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës.

⁵ Neni 4 paragrafi 1 i Kartës.

⁶ P.sh. Rregullorja e UNMIK-ut 2001/09 mbi Kornizën Kushtetuese për Vetëqeverisjen e Përkohshme në Kosovë.

⁷ Neni 11.1 i Rregullores së UNMIK-ut 2007/30.

⁸ Neni 11.1 i Rregullores së UNMIK-ut 2007/30.

⁹ Neni 11.2 i Rregullores së UNMIK-ut 2007/30.

Legjislacioni i nivelit lokal përbëhet nga Rregulloret dhe Vendimet Komunale. Rregullorja Komunale është akt normativ që në mënyrë abstrakte dhe të përgjithësuar rregullon numrin e rasteve, ndërsa Vendimi komunal është akt normativ që rregullon rastet individuale dhe konkrete. Rregulloret komunale dhe Vendimet komunale janë të limituara brenda territorit të komunës, ashtu si përcaktohet në mënyrë specifike nga dispozitat relevante për kufijtë e komunës, dhe mund të aplikohen jashtë atyre kufijve vetëm në rastet e përcaktuara në mënyrë specifike me ligj. Rregullorja Komunale duhet të korrespondojë me Rregulloret e UNMIK-ut dhe me ligjet e Kuvendit të Kosovës.

Tabela 1. Rregulloret dhe Vendimet Komunale


Rregulloret komunale	Vendimet Komunale
<ul style="list-style-type: none">- Abstrakte- Të përgjithshme- Numri i rasteve- Konsultimi i komiteteve dhe publikut është i obligueshëm	<ul style="list-style-type: none">- Individuale- Konkrete- Rast i vetëm- Konsultimi i komiteteve dhe publikut nuk është i obligueshëm

Është esenciale për komunat që nëse janë në dyshim sa i përket kuptimit apo interpretimit të ligjit të zbatueshëm, të kërkojnë asistencë nga Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal për të siguruar implementimin e drejtë të dispozitave relevante. Organet komunale mund të dorëzojnë në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal kërkesën për interpretim të akteve legjislative që kanë ndikim në komunat. Kjo formë e bashkëpunimit dhe asistencës është pjesë e përkrahjes administrative të Ministrisë për aktivitetet e autoriteteve lokale, që synon “sigurimin e pajtueshmërisë me ligjin dhe parimet kushtetuese.”¹⁰

Ndryshimet në ligjin e nivelit qendror sa i përket komunave, kërkojnë gjithashtu analizë të plotë të Statuteve, për të konstatuar nëse janë të nevojshme amendamentet për shmangie të kundërthënies të mundshme. Për shembull, Ligji i ardhshëm për Financat Komunale mund të shtrojë nevojën e përshtatjes së Statutit nga ana e kuvendeve komunale. Kuvendi Komunal duhet të sigurojë harmoninë dhe zbatueshmërinë e përhershme të Statutit.

¹⁰ Neni 8.2 i Kartës; Aneksi XIV (iii) i Nenit 1 të Rregullores së UNMIK-ut 2005/15 me të cilën ndryshohet Rregullorja e UNMIK-ut 2001/19 për Degën Ekzekutive të Institucioneve të Përkohshme të Vetëqeverisjes në Kosovë; dhe Rregullorja e UNMIK-ut 2007/18 me të cilën ndryshohet Rregullorja e UNMIK-ut 2001/19 për Degën Ekzekutive të Institucioneve të Përkohshme të Vetëqeverisjes në Kosovë.

Tabela 2. Hierarkia e legjislacionit që lidhet me nivelin komunal



Rekomandimet:

- Komunat duhet të sigurojnë pajtueshmërinë e Statutit të tyre me ligjin e zbatueshëm;
- Komunat duhet të sigurojnë këshilla nga Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal në rast të mospajtueshmërisë eventuale të Statutit të tyre me ligjin e zbatueshëm;
- Komunat duhet t'i referohen ligjit të zbatueshëm për të mësuar fushën e saktë të kompetencave të tyre ligjore, dhe të përgjegjësive e detyrave të tyre;
- Komunat duhet të shmangin riprodhimin e dispozitave të ligjit në Statutet e tyre, për të zvogëluar rrezikun e implementimit të dispozitave që dallojnë nga legjislacioni dhe për të shmangur krijimin e situatës së paligjshme.
- Kryetari i Komunës duhet të sigurojë pajtueshmërinë e përhershme të Statutit me ligjin e zbatueshëm.

KAPITULLI II. PARIMET UDHËHEQËSE

2.1 Reflektimi i vlerave dhe karakteristikave të komunitetit

Karta përcakton parimet që standardizojnë praktikën e qeverisjes lokale në vendet anëtare të Këshillit të Evropës. Ajo lë hapësirë të konsiderueshme për interpretim. Secili vend anëtar lejohet të dizajnojë sistemin e tij të qeverisjes lokale që pasqyron traditat e veta administrative.

Rregullorja e UNMIK-ut 2007/30 gjithashtu lë hapësirë për interpretime të mëtejme. Ajo përcakton aranzhimet e përgjithshme politike dhe përgjegjësitë e komunave dhe përcakton organet kryesore legjislative dhe ekzekutive. Rregullorja nuk ofron udhëzime të hollësishme. Ajo u lë hapësirë komunave që të dizajnojnë aranzhimet e veta organizative e procedurale. Për shembull, Rregullorja e UNMIK-ut 2007/30 u lejon komunave që të bëjnë aranzhime me fshatrat¹¹, vendbanimet dhe lagjet urbane që ekzistojnë në territorin e tyre; të bëjnë aranzhime në mes vete; të mundësojnë pjesëmarrjen e publikut në takime; të bëjnë rregullimin e hollësishëm të përdorimit të gjuhëve të komuniteteve; t'i japin përgjegjësi shtesë Kryetarit të Komunës apo Drejtuesit të Administratës dhe Personelit, e kështu me radhë. Këto aranzhime dhe dispozita duhet të formalizohen në Statut.

Ndërsa bën rregullimin e hollësishëm të këtyre aranzhimeve dhe dispozitave, Komuna duhet të ketë parasysh karakteristikat e komuniteteve të saj, kulturën, interesat ekonomike, përbërjen linguistike e sociale, si dhe prioritetet dhe resurset specifike të tyre. Ndryshimet që prekin popullatën dhe komunitetet e komunës shtrojnë nevojën për një lexim të plotë të Statutit, për të parë nëse janë të nevojshme përshtatjet.

Statuti siguron sistemin e kontrolleve reciproke në mes të organeve legjislative e ekzekutive të komunës. Së këndejmi, ai duhet të përcaktojë mënyrën në të cilën Kuvendi Komunal kontrollon implementimin e Rregulloreve komunale dhe të sigurojë procedurat e intervenimit në rast se identifikohen parregullsi. Kryetari i Komunës është përgjegjës për të siguruar që Statuti i Komunës është i azhurnuar dhe pasqyron në mënyrë adekuate karakteristikat e komunitetit.

Rekomandimet:

- Statutet Komunale duhet të definojnë strukturën administrative interne të komunës dhe rolin e detyrat e organeve komunale;
- Komunitet duhet të sigurojnë që Statutet e tyre do të azhurnohen çdo herë dhe që pasqyrojnë strukturat aktuale, procedurat dhe funksionet e komunave;
- Komunitet duhet të marrë parasysh karakteristikat e komuniteteve të saj, kulturën, interesat ekonomike, përbërjen linguistike e sociale, si dhe prioritetet e resurset specifike të tyre.
- Kryetari i Komunës është përgjegjës për të siguruar që Statuti i Komunës është i azhurnuar dhe pasqyron në mënyrë adekuate strukturën dhe procedurat që janë aktualisht në zbatim në komunë.

¹¹ UNMIK Administrative Direction NO. 2004/23 determines the villages

2.2 Pjesëmarrja e publikut dhe konsultimet

Statutet duhet të “sigurojnë një shkallë të gjerë të instrumenteve të pjesëmarrjes, t’i kombinojnë dhe adaptojnë ato me rrethanat, të promovojnë kulturën e pjesëmarrjes demokratike në mes të komuniteteve dhe autoriteteve lokale.”¹²

2.2.1 Baza ligjore për konsultimet publike dhe pjesëmarrjen

Komiteti i Ministrave të Këshillit të Evropës, në Rekomandimin e tij 2001-19 thotë që “dialogu në mes të qytetarëve dhe përfaqësuesve të zgjedhur lokal është esencial për demokracinë lokale, pasi që fuqizon legjitimitetin e institucioneve demokratike lokale dhe efikasitetin e veprimit të tyre.”¹³ Ai thekson që “pjesëmarrja e qytetarëve është mu në thelb të idesë së demokracisë dhe që qytetarët e përkushtuar ndaj vlerave demokratike, të ndërgjegjshëm për detyrat e tyre civile dhe që angazhohen në aktivitetet politike, janë forcë esenciale e secilit sistem demokratik”¹⁴

Karta njih “të drejtën dhe aftësinë e autoriteteve lokale ... për rregullim dhe menaxhim të një pjese të konsiderueshme të çështjeve publike ... në interes të popullatës lokale”¹⁵ dhe deklaroi që “kjo e drejtë ushtrohet nga këshillat apo asamblatë e përbëra nga anëtarët e zgjedhur lirshëm”¹⁶. Megjithatë, ajo thekson që e tërë kjo “nuk ndikon në asnjë mënyrë në adresimin e këtyre çështjeve në asamble të qytetarëve, referendume apo forma të tjera të pjesëmarrjes së drejtpërdrejtë të qytetarëve.”

Rregullorja e UNMIK-ut 2007/30 përcakton që takimet publike të mbahen në mënyrë periodike, të paktën dy herë në vit. Duhet dhënë njoftimi publik për datën dhe vendin e mbajtjes së secilit takim publik, të paktën dy javë përpara. Secili person apo organizatë me interes në komunë, ka të drejtën e paraqitjes së peticionit në Kuvendin Komunal, lidhur me cilëndo çështje që lidhet me përgjegjësitë dhe kompetencat e komunës. Anëtarët e publikut, përfshirë këtu përfaqësuesit e shtypit, do të lejohen në të gjitha takimet e Kuvendit Komunal dhe të komiteteve të tij, si dhe në të gjitha takimet e Bordit të Drejtorëve.¹⁷

Sipas Rregullores së UNMIK-ut 2007/30 çdo person mund të inspektojë dokumentet që mbahen nga komuna, në përputhje me ligjin e zbatueshëm për qasje në dokumentet zyrtare.

¹² Shtojca 1, Paragrafi 2 dhe 6, Rekomandimi 2001/19 i Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës.

¹³ Paragrafi 11, Rekomandimi 2001/19 i Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës.

¹⁴ Preambula e Kartës.

¹⁵ Neni 3.2 i Kartës.

¹⁶ Neni 3.2 i Kartës.

¹⁷ Nenet 7.1 dhe 8.1 të Rregullores së UNMIK-ut 2007/30.

2.2.2 Dëgjimet publike, aktivitetet jashtë zyrës dhe grupet e interesit

Konsultimi publik është mjet modern i qeverisjes së mirë dhe i bërjes së politikave, që përdoret në të gjitha nivelet e administratës, përfshirë këtu qeverinë lokale. Konsultimi publik siguron që banorët e interesuar kanë mundësinë e shprehjes së opinionëve të tyre dhe që pritjet e tyre do të dëgjohen dhe – në mënyrë ideale – do të merren parasysh. Ai mundëson mbledhjen e ideve dhe opsioneve, dhe përmirëson të kuptuarit e nevojave të pjesëve të ndryshme të popullatës. Konsultimi publik mund të zgjidhë problemet potenciale në faza të hershme dhe mund të kontribuojë në implementimin e patrazuar të legjislacionit komunal. Pjesëmarrja e publikut në procesin e vendimmarrjes shton interesimin e qytetarëve në aktivitetet e komunës dhe i përkrahë programet dhe aktivitetet e komunës.

Janë disa lloje të ndryshme të konsultimit publik për të forcuar përfshirjen në procesin e vendimmarrjes dhe krijimit të politikave:

- Në Dëgjimin publik, nga publiku kërkohet të shprehë qëndrimet e tij për një temë speciale, për të cilën janë në dispozicion informatat dhe dokumentet. Në takimin publik prezantohen informatat dhe qytetarët mund të bëjnë pyetje apo komente.
- Kontakti i rregullt me grupet e interesit mundëson mbajtjen e diskutimeve me qarqet e vogla që kanë interes në një aktivitet specifik të komunës. Kjo mundëson rezultate të fokusuara që lidhen me interesat direkte të grupit, por është më pak përfshirës për anëtarët e komunitetit të përgjithshëm.
- Takimet publike, aktivitetet jashtë zyrës dhe fushatat informuese në çështjet specifike për publikun në përgjithësi apo për grupet specifike, shërbejnë si platforma për sigurim të informatave dhe për promovim të ndërgjegjësimit. Kjo mund të jetë veçmas e dobishme si reagim ndaj ankesave të qytetarëve lidhur me shërbimet komunale (sikur që është furnizimi me ujë, menaxhimi i mbeturinave, cilësia e shtrimit të rrugëve). Aktiviteti jashtë zyrës mund të jetë mënyrë e shkëlqyer për Komitetin e Komuniteteve dhe Komitetin e Ndërmjetësimit, për të bërë publike mandatet e tyre dhe për ti shpjeguar të drejtat dhe mjetet juridike në rastet e diskriminimit.

Komuna duhet të sigurojë kohë të mjaftueshme, preferohet tetë deri në dymbëdhjetë javë përpara, për pranim të përgjigjeve rreth konsultimit publik. Reagimet duhet të pranohen dhe të analizohen, dhe rezultatet duhet të vihen gjerësisht në dispozicion, duke marrë parasysh qëndrimet e shprehura dhe shkaqet për vendimet finale të marra. Rezultatet e konsultimit të hapur publik duhet të prezantohen në ueb faqen e komunës.

Projektet dhe politikat zakonisht u nënshtrohen kufizimeve financiare, prandaj varen në masë të madhe nga fondet buxhetore dhe prioritetet. Prandaj, për të siguruar një pjesëmarrje efektive, qytetarët duhet të përfshihen në procesin e buxhetimit. Aktivitetet buxhetore jashtë zyrës në disa komunitete dhe qytete, dhe takimet e rregullta publike për buxhetin, mund të jenë mënyrë e dobishme për konstatimin e prioritetëve kryesorë dhe shqetësimeve të popullatës së komunës.

Statuti duhet të përcaktojë cilat lloje të konsultimeve publike janë në dispozicion në komunë, nëse ato mbahen gojariht apo me shkrim, kohën dhe afatet e fundit për ato konsultime si dhe gjuhët që përdoren.

2.2.3 Takimet publike vjetore

Komunat do të mbajnë takime të rregullta publike, të paktën dy herë në vit¹⁸, në të cilat mund të marrë pjesë secili person apo organizatë, me qëllim të marrjes së informatave dhe diskutimit të politikave dhe aktiviteteve komunale, dhe zhvillimeve të ardhshme.

Pyetjeve të publikut duhet dhënë përgjigje e menjëhershme apo me shkrim, brenda një kohe të arsyeshme por jo më larg se pas një muaji nga mbajtja e takimit. Autoritetet komunale dhe përfaqësuesit e komuniteteve do të bashkëpunojnë në përpilimin e agjendës, që duhet nxjerrë dy javë përpara. Takimet publike kryesohen nga Kryetari i Komunës.

Statuti duhet të përfshijë dispozita për shpalljen e takimit publik, për gjuhët, agjendën, procesverbalin dhe orarin kohor brenda të cilit duhet dhënë përgjigje qytetarëve. Statutet duhet të vendosin datën e këtyre takimeve dhe të kenë parasysh një kohë të arsyeshme që banorët të përgatiten për takimet, dhe që takimet të mbahen në një ditë të përshtatshme për të gjitha komunitetet në komunë. Festat fetare dhe periudhat e ngjashme të rëndësishme të veçantë duhet të shmangen poashtu.

2.2.4 Takimet e Kuvendit Komunal dhe të Komiteteve

Publiku, përfshirë këtu përfaqësuesit e mediave mund të marrin pjesë në takimet e Kuvendit Komunal, komiteteve të tij dhe në takimet e Bordit të Drejtorëve, për t'u njoftuar me të gjitha çështjet e diskutuara sa i përket administrimit të komunës.¹⁹ Komuna duhet të bëjë njoftimin sa i përket kohës dhe vendit për mbajtjen e secilit takim dhe t'i vë lehtësisht në dispozicion (p.sh. njoftimet në gazeta, vendosja e lajmërimeve në ndërtesat publike dhe vendet e popullarizuara në fshatra). Njoftimi publik duhet të bëjë të njohura temat që do të diskutohen gjatë takimit.

Përfshirja e mediave duhet të konsiderohet si mënyrë për informimin e publikut për projektet e rëndësishme të komunave dhe për të rritur kredibilitetin e komunës përmes transparencës së shtuar. Për më shumë, është e këshillueshme për organet komunale që të lejojnë qasjen e duhur në ato dokumente që janë temë e takimeve. Kjo do t'u ndihmojë individëve të interesuar dhe përfaqësuesve të mediave që të përgatiten për takimin.

Statuti duhet të përcaktojë një afat të arsyeshëm kohor dhe mënyrën për njoftimin e mbajtjes së takimeve të Kuvendit Komunal, komiteteve të tij dhe të Bordit të Drejtorëve. Aty duhet të ketë dispozita të qarta për qasjen në dokumentet relevante, për rregullat lidhur me rendin dhe etikën gjatë këtyre takimeve, dhe rregullave të tjera që lehtësojnë pjesëmarrjen e publikut.

¹⁸ Neni 8 I Rregullores së UNMIK-ut 2007/30.

¹⁹ Neni 7.1 i Rregullores së UNMIK-ut 2007/30.

2.2.5 Situatat që arsyetojnë përjashtimin e publikut nga takimet e komunës

Në rrethana të caktuara, mund të jetë e përshtatshme apo edhe esenciale përjashtimi i publikut nga takimet e komiteteve apo Bordit të drejtorëve të Komunës.²⁰ Parakushtet e tilla mund të jenë:

- Tema e diskutimit apo informatave mund të vë në rrezik integritetin e individëve;
- Tema e diskutimit apo informatave mund të vë në rrezik sigurinë e Kosovës apo të komunës (veçmas sa u përket çështjeve të mbrojtjes dhe atyre ushtarake), nëse rrezikon sigurinë e individëve apo mund të shkaktojë trazira publike apo dhunë;
- Tema e diskutimit apo informatës ka të bëjë me politikën financiare apo ekonomike të autoriteteve qendrore apo ka efekte serioze të pafavorshme në interesin ekonomik të saj;
- Tema e diskutimit apo informatës ka të bëjë me një qeveri të huaj apo me një organizatë ndërkombëtare dhe mund të dëmtojë marrëdhëniet ndërkombëtare;
- Tema e diskutimit apo informatës ka të bëjë me procedimet gjyqësore dhe këshillat ligjore.

Në të gjitha ato situata, publiku, përfshirë këtu përfaqësuesit e mediave, mund të përjashtohen nga i tërë takimi apo nga pjesë të caktuara të tij. Megjithatë, kjo e drejtë nuk duhet të shfrytëzohet me tepri. Përjashtimi i publikut dhe mediave duhet gjithherë të arsyetohet dhe të peshohet mirë. Mundësia e hapur e pjesëmarrjes në takime duhet të jetë rregull dhe përjashtimi duhet të kufizohet rreptësisht në rastet speciale. Takimet e Kuvendit Komunal janë çdo herë publike.

Statuti duhet të përmbajë dispozita për parakushtet nën të cilat publiku mund të përjashtohet nga takimet e komiteteve të Kuvendit Komunal dhe Bordit të Drejtorëve. Aty duhet të përcaktohen rregullat për atë se kush duhet të vendosë për përjashtimin e publikut, p.sh. kryesuesi apo shumica e anëtarëve, si dhe për mënyrën e bërjes së atij njoftimi.

2.2.6 Peticionet

Secili person apo organizatë me interes në punët e komunës ka të drejtë në paraqitjen e petitionit në Kuvendin Komunal, për cilëndo çështje që lidhet me punën e Komunës. Peticioni është kërkesë apo pyetje për Kuvendin, për t'u marrë me çështjet specifike apo për të miratuar ligje të caktuara dhe përbën një të drejtë themelore demokratike.

Kuvendi Komunal duhet të njohë rëndësinë e petitionit dhe t'u përgjigjet të gjitha pyetjeve dhe kërkesave të përfshira në petition. Peticioni mund të rezultojë gjithashtu me mbajtjen e takimit publik në të cilin popullata diskuton, bashkë me zyrtarët komunal, për çështjet me interes për ta..

Statuti duhet të rregullojë procedurën e dorëzimit të petitionit dhe cila zyrë e komunës është përgjegjëse për pranimin e petitionit. Veç kësaj, Statuti duhet të përcaktojë nëse përgjigjet do të duhet të jenë të arsyetuara dhe të justifikuar si dhe afatin kohor për përgjigje.

²⁰ Neni 7.3 i Rregullores së UNMIK-ut 2007/30.

Rekomandimet:

- Statuti duhet të përcaktojë afatin e arsyeshëm kohor për shpallje të njoftimit për mbajtjen e takimeve zyrtare të komunës;
- Statuti duhet të përcaktojë vendosjen e njoftimeve publike në vende lehtësisht të arritshme, shpalljen në media dhe sigurimin e agjendës, përfshirë këtu të gjitha pikat që do të diskutohen në takimin publik, në të gjitha gjuhët zyrtare të komunës;
- Statuti duhet të autorizojë Kryesuesin e të gjitha takimeve zyrtare komunale për të siguruar mbajtjen e rendit gjatë periudhës publike të pyetjeve dhe komenteve;
- Përrjashtimi i publikut nga takimi komunal bëhet vetëm kur ka një situatë valide që e justifikon këtë përrjashtim dhe vetëm për kohën që është e nevojshme për diskutimin apo prezantimin e kësaj situatë;
- Takimet publike vjetore, që mbahen të paktën dy herë në vit, duhet të mbahen në vende dhe kohë që është më e përrshtatshme për komunitetet e ndryshme apo lokalitetet e komunës;
- Statuti duhet të përcaktojë Kryesuesin e këtyre takimeve publike vjetore dhe të specifikojë që duhet mbajtur procesverbali për të gjitha propozimet dhe kërkesat e bëra nga banorët;
- Statuti duhet të specifikojë afatin e fundit kohor në të cilin Kuvendi Komunal duhet t'u përrgjigjet propozimeve dhe kërkesave të shtruara nga banorët, përrmes takimeve publike vjetore apo peticioneve;
- Statuti duhet të specifikojë procedurën për ushtrimin e së drejtës nga banorët për paraqitje të peticioneve në Kuvendin Komunal;
- Statuti mund të parashohë krijimin e komisionit special për analizim të peticionit të paraqitur nga një pjesë e rëndësishme e popullatës;
- Komunat duhet të kenë një proces buxhetor me pjesëmarrje, që përrfshin pjesëmarrjen e publikut në fazën e zhvillimit të buxhetit;
- Statuti duhet të definojë metodën e informimit të publikut lidhur me punën e bërë nga të gjitha organet komunale;

KAPITULLI III. STRUKTURA E QEVERISË LOKALE

3.1 Dega Ekzekutive

Dega ekzekutive e komunës ka dy organe: Kryetarin e Komunës dhe Bordin e Drejtorëve me departamentet e tyre. Paragrafët në vijim ofrojnë udhëzime rreth mënyrës së detajizimit të mëtejme të funksionimit të tyre me Statutin e Komunës.

3.1. 1 Kryetari i Komunës

Ndryshimi më i rëndësishëm që rrjedh nga Rregullorja e UNMIK-ut 2007/30 është Kryetari i Komunës që zgjedhet drejtpërdrejtë. Ky ndryshim është bërë me Rregulloren e UNMIK-ut 2007/27 për “Zgjedhjet komunale në Kosovë” që për herë të parë krijon bazën ligjore për mbajtje të zgjedhjeve të drejtpërdrejta për Kryetar të Komunës.

Seksioni 27 i Rregullorës së UNMIK-ut 2007/30²¹ i jep autorizime të gjera institucionit të Kryetarit të Komunës, sikur që janë:


- Kryesimi i takimeve të Kuvendit Komunal, përfshirë këtu të drejtën e votës kur numri i votave për dhe kundër është i njëjtë;
- Kryesimi i takimi të Bordit të Drejtorëve
- Kryesimi i takimeve të Komitetit për Politika e Financa dhe e drejta e votës kur numri i votave për dhe kundër është i njëjtë;
- Emërimi dhe shkarkimi i anëtarëve të Bordit të Drejtorëve, me përjashtim të Shefit të Administratës dhe Personelit;
- Propozimi i buxhetit vjetor para Kuvendit Komunal, për miratim nga ky i fundit, dhe
- Raportimi në Kuvendin Komunal të paktën në çdo tre muaj, etj.

Statuti duhet të përcaktojë rregullat në vijim për përgjegjësitë e Kryetarit të Komunës:

- Kryetari i Komunës emëron një anëtar të Bordit të Drejtorëve që do të ushtrojë përgjegjësitë e Kryetarit në mungesë të tij apo saj, përveçse për përgjegjësitë e caktuara për Zëvendës Kryesuesin e Kuvendit Komunal;
- Kryetari i Komunës siguron që Statuti është gjithëherë i saktë dhe pasqyron strukturat, procedurat dhe funksionet e komunave dhe ai/ajo do ta alarmojë Kuvendin Komunal nëse ai/ajo e sheh të arsyeshme;
- Kryetari i Komunës përcakton kriteret dhe procedurat e prioriteteve për projektet për nevojat e buxhetit vjetor;
- Statuti duhet të rregullojë procedurat e konsultimit të Kuvendit Komunal sa i përket nominimit të anëtarëve të Bordit të Drejtorëve.

²¹ Neni 27 i Rregullores së UNMIK-ut 2007/30.

Tabela 3. Strukturat komunale legjislative dhe ekzekutive



3.1.2 Bordi i Drejtorëve dhe departamentet komunale

Në përputhje me Seksionin 29 të Rregullorës së UNMIK-ut 2007/30²², me Statut themelohen departamentet komunale, që përfshijnë Departamentin e Administratës dhe Personelit, Departamentin e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, Departamentin e Edukimit dhe Kulturës, Departamentin e Financave, Ekonomisë dhe Zhvillimit, Departamentin e Planifikimit Urban, Kadastrit dhe Mbrojtjes së Mjedisit, Zyrën Komunale të Komuniteteve, dhe Departamentet tjera që shihen të nevojshme dhe të duhura për ushtrimin e funksioneve dhe përgjegjësi të komunës.

Statuti definon të drejtat dhe përgjegjësitë e Drejtorëve të Departamenteve dhe Shefave të Departamenteve. Marrëdhëniet e tyre duhet definuar gjithashtu, për të siguruar fusha të qarta të përgjegjësi. Po e njëjta gjë duhet bërë sa i përket Shefit të Administratës dhe Personelit që shërben si Sekretar i Kuvendit Komunal dhe Bordit të Drejtorëve dhe vepron si shërbyes i lartë civil në komunë. Ai/Ajo rekrutohet në pajtim me ligjin e zbatueshëm për shërbimin civil të Kosovës²³. Në definimin e përgjegjësi të tij/saj, Statuti do të përcaktojë marrëdhënien në mes të tij/saj dhe Kryetarit të Komunës, si dhe rolin e tij/saj si hallkë në mes të Kuvendit Komunal dhe Kryetarit të Komunës.

Rekomandimet:

- Statuti do të theksojë përgjegjësitë e Kryetarit të Komunës, veç atyre të përcaktuara me Rregulloren e UNMIK-ut 2007/30;
- Statuti do të themelojë Departamentet Komunale dhe do të theksojë rolet përkatëse të tyre;
- Statuti do të theksojë rolet përkatëse të Drejtorëve të secilit Departament;
- Shefi i Departamentit të Administratës dhe Personelit duhet të ketë kualifikimet e parapara me Statut dhe do të shërbejë si shërbyes i lartë civil në komunë.

²² Neni 29 i Rregullores së UNMIK-ut 2007/30.

²³ Rregullorja e UNMIK-ut 2001/36 për Shërbimin Civil të Kosovës.

3.2 Dega Legjislative

Dega legjislative e komunës përbëhet nga Kuvendi Komunal dhe komitetet e tij. Si mund të adresohet funksionimi i tyre në Statut është përshkruar në paragrafët e mëposhtëm.

3.2.1 Kuvendi Komunal

Kuvendi Komunal është organ ligjvënës i komunës. Është trup një dhomësh, i përbërë nga plenumi dhe komitetet. Të dyja këto, seanca plenare dhe komitetet, takohen rregullisht, të paktën dhjetë herë në vit, për miratimin e legjislacionit komunal dhe për diskutimin e çështjeve me interes për komunën.²⁴

Në mungesë të Kryetarit të Komunës, nën-kryetari kryeson seancat e Kuvendit Komunal. Ai/Ajo zgjedhet nga shumica e anëtarëve të Kuvendit Komunal. Në komunat me më tepër se një komunitet pakicë, Kuvendi Komunal zgjedh nën-kryetarin e dytë nga komuniteti që nuk është në shumicën në Komunë.

Për shkak se Rregullorja e UNMIK-ut 2007/30 kërkon që me Statut të rregullohet implementimi i përgjegjësive të komunës, Statuti së pari duhet të definojë kush mban të drejtën për inicim të legjislacionit, përveç degës ekzekutive. Kjo e drejtë për shembull mund t'u ipet anëtarëve të Kuvendit Komunal apo një përbërjeje të caktuar të anëtarëve.

Veç kësaj, Statuti rregullon të drejtën e entiteteve politike dhe të komuniteteve të përfaqësuara në Kuvendin Komunal për të shtuar çështje me interes për to në agjendë, për të folur para plenumit dhe për të iniciuar legjislacionin. Kjo buron nga fakti që Kuvendi Komunal është gjithashtu trup kontrollues që siguron se organet ekzekutive dhe administrata civile veprojnë në pajtim me ligjin. Duke e rregulluar këtë, Statutet sigurojnë që Kuvendi Komunal mund të shërbejë si platformë për shkëmbim të opinioneve.

Statuti rregullon më tej hollësitë e sistemit të kontrolleve reciproke në mes të organeve legjislative dhe ekzekutive të komunës. Ai duhet të përcaktojë mënyrën në të cilën Kuvendi Komunal kontrollon implementimin e Rregulloreve Komunale dhe siguron procedurat për intervenime në rast të identifikimit të parregullsive.

Kuvendi Komunal nxjerr Rregullat e Procedurës për adresim të çështjeve teknike të punës së seancave plenare dhe komiteteve. Për shembull, duhet të përmbajë dispozita për përgatitjen dhe publikimin e agjendës, procedurën për regjistrim të mocioneve dhe aplikacioneve, si dhe për distribuim të punës në mes komiteteve. Takimet e Kuvendit Komunal thirren nga Kryetari i Komunës²⁵ dhe procesverbalet e takimeve mbahen nga Shefi i Departamentit të Administratës dhe Personelit²⁶.

²⁴ Neni 15 i Rregullores së UNMIK-ut 2007/30.

²⁵ Neni 15 i Rregullores së UNMIK-ut 2007/30.

²⁶ Neni 16 i Rregullores së UNMIK-ut 2007/30.

Kryetari i Komunës u siguron anëtarëve të Kuvendit Komunal dhe anëtarëve të komiteteve agjendën e Kuvendit Komunal dhe dokumentet relevante, para mbajtjes së secilit takim, duke mundësuar kështu kohë të mjaftueshme për përgatitje dhe për sugjerim të ndryshimeve në agjendë. Takimet kryesohen nga Kryetari i Komunës, që shërben si hallkë në mes të degëve legjislative dhe ekzekutive. Si kryesues i Kuvendit Komunal, ai/ajo siguron pavarësinë e Kuvendit Komunal, barazinë e të drejtave të secilit anëtar dhe procedura transparente legjislative. Megjithatë, ai/ajo nuk është anëtar i zgjedhur i Kuvendit Komunal. Së këndejmi, ai/ajo duhet, për aq sa është e mundur, të përmbahet nga ushtrimi i ndikimit në procesin e vendimmarrjes së Kuvendit Komunal.

Anëtarët e komuniteteve kanë të drejtë të komunikojnë në gjuhën e tyre me të gjitha organet komunale dhe me të gjithë shërbyesit civil. Takimet e Kuvendit Komunal, të komiteteve të tij, takimet e Bordit të Drejtorëve, por edhe të gjitha takimet publike, zhvillohen në gjuhët Shqipe e Serbe. Veç kësaj, të gjitha dokumentet zyrtare të komunës do të printohen në të dyja gjuhët. Në Statut, Kuvendi Komunal harton dispozita të hollësishme për përdorimin e gjuhëve²⁷.

Rekomandimi:

- Statuti definojnë kush ka të drejtën e inicimit të legjislacionit përveç degës ekzekutive.
- Statuti rregullon të drejtën e entiteteve politike dhe të komuniteteve të përfaqësuara në Kuvendin Komunal për të shtuar çështje me interes për to në agjendë, për të folur para plenumit dhe për të iniciuar legjislacionin.
- Statuti detajizon më tej sistemin e kontrolleve reciproke në mes të organeve legjislative e ekzekutive të komunës.
- Statuti përcakton me dispozitë të qartë përdorimin e gjuhëve në pajtim me Nenin 9.5 të Rregullores së UNMIK-ut 2007/30, duke marrë parasysh përbërjen e komuniteteve në komunë.

²⁷ Neni 9 i Rregullores së UNMIK-ut 2007/30.

3.2.1.1 Komitetet e Kuvendit Komunal

Komiteti është i ngjashëm me grupin punues që diskuton për çështje specifike rreth akteve normative të propozuara dhe në këtë mënyrë përgatitë aktet ligjore dhe vendimet që do të merren nga Kuvendi Komunal. Së këndejmi, Kuvendi Komunal e konsideron punën e komiteteve si kontribut thelbësor për procesin e tij të vendimmarrjes.

Parimet bazë për anëtarësinë e secilit komitet janë rregulluar me Rregulloren e UNMIK-ut 2007/30²⁸. Numri i anëtarëve të secilit Komitet përcaktohet me Statut. Komitetet tjera përveç Komitetit për Politika e Financa, mund të përbëhen gjithashtu nga anëtarë që nuk janë anëtarë të Kuvendit Komunal. Këta anëtarë kanë të drejta të njëjta votimi dhe të drejta të tjera në kuadër të komitetit, ngjashëm me ata që janë anëtarë të Kuvendit Komunal. Sidoqoftë, shumica e anëtarëve të secilit komitet duhet të jenë anëtarë të Kuvendit Komunal. Anëtarët e secilit komitet duhet të kenë përvojë në fushën e tij të përgjegjësisë. Komitetet mund gjithashtu të ftojë ekspertë nga jashtë Kuvendit për prezantim të opinioneve të tyre në temat e caktuara. Një anëtar i Kuvendit Komunal mund të jetë anëtar i më tepër se një komiteti. Rregullimi më i hollësishëm i anëtarësisë së komiteteve është lënë për t'u përcaktuar me Statut.

Gjatë emërimit të anëtarëve të komitetit, Kuvendi Komunal duhet të ketë parasysh balancin e drejtë gjinor. Veç kësaj, anëtarësia e secilit komitet duhet të reflektojë poashtu proporcionin e ulëseve që mbahen nga partitë politike në Kuvendin Komuna (përfshirë nga kjo rregull bën Komiteti për Komunitete dhe Komiteti për Ndërmjetësim). Barazia gjinore duhet të merret parasysh edhe në hartimin e Statutit.

Secili komitet zgjedh kryesuesin në takimin e tij të parë. Statuti do të rregullojë që secili kryesues i komiteteve duhet të ketë mundësinë të takohet rregullisht me Kryetarin e Komunës në cilësinë e tij/saj si kryesues i Kuvendit Komunal, të paktën një herë në çdo dy muaj, për të adresuar çështjet lidhur me fushën e përgjegjësisë së komitetit. Kryesuesi i Komitetit për Komunitete dhe Komitetit për Ndërmjetësim duhet të kenë gjithashtu të drejtën ta bëjnë këtë të paktën një herë në muaj. Kryetari i Komunës duhet të bashkëpunojë ngushtë me kryesuesit e komiteteve, veçmas me kryesuesit e Komiteteve për Komunitete dhe atij për Ndërmjetësim.

Për të siguruar funksionimin e secilit komitet, Kuvendi Komunal siguron resurset financiare që janë në përpjesëtim të drejtë me detyrat dhe punën e secilit komitet. Për çdo vit, buxheti i secilit komitet rishikohet në aspekt të shtrirjes së aktiviteteve të secilit komitet, dhe kur është e nevojshme bëhen ndryshimet përkatëse. Komitetet i ofrojnë Kuvendit Komunal raportin vjetor të punës dhe të arriturave të tyre, për të mundësuar vlerësimin e buxhetit të alokuar për secilin komitet, dhe për të shtuar përgjegjshmërinë e tyre.

Veç kësaj, me Statut duhet kërkuar nga secili komitet nxjerrjen e Rregullave të Procedurës. Këto Rregulla të Procedurës rregullojnë kompetencat e secilit komitet, kohën e takimeve, alokimin e resurseve financiare dhe bashkëpunimin e komiteteve me organet tjera komunale.

²⁸ Neni 21 i Rregullores së UNMIK-ut 2007/30.

Kuvendi Komunal duhet të aprovojë një katalog të gjerë të kompetencave për secilin komitet, për të shmangur përkimin e përgjegjësive dhe për të mundësuar vlerësimin e arsyeshëm të buxhetit të tyre.

Rekomandimet:

- Statutet Komunale duhet të përmendin nevojën për barazi gjinore në organet e komunës.
- Statutet Komunale duhet të rregullojnë që secili kryesues i komiteteve të ketë mundësinë të takohet me Kryetarin e Komunës, në cilësinë e tij/saj si kryesues i Kuvendit Komunal, në bazë të rregullt dhe të paktën një herë në çdo dy muaj.
- Statutet Komunale duhet të rregullojnë që kryesuesi i Komitetit për Komunitete dhe Komitetit për Ndërmjetësim duhet të kenë mundësinë të takohen me Kryetarin e Komunës, në cilësinë e tij/saj si kryesues i Kuvendit Komunal, në bazë të rregullt dhe të paktën një herë në muaj.

3.2.1.2 Komitetet e detyrueshme

Statuti duhet të respektojë Rregulloren e UNMIK-ut 2007/30 që e bën të detyrueshme për secilën komunë themelimin e komiteteve në vijim:

- Komiteti për Politika e Financa
- Komiteti për Komunitete dhe Komiteti për Ndërmjetësim
- Komiteti për Shëndetësi e Mirëqenie Sociale
- Komiteti për Edukim e Kulturë
- Komiteti për Zhvillim Ekonomik
- Komiteti për Planifikim Urban, Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit.

3.2.1.2.1 Komiteti për Politika e Financa

Në pajtim me Rregulloren e UNMIK-ut 2007/30²⁹ Komiteti për Politika e Financa është përgjegjës për propozimin e buxhetit si dhe për formulimin dhe studimin e drejtimit të ardhshëm strategjik të komunës. Kryetari i Komunës është kryesues zyrtar i këtij komiteti. Së këndejmi, Statuti duhet të njohë rolin e tij të rëndësishëm në vendimmarrjen komunale. Komiteti për Politika e Financa, në bazë të propozimit të Kryetarit të Komunës, propozon prioritetet financiare dhe buxhetin vjetor para Kuvendit Komunal dhe monitoron performansën e buxhetit vjetor. Veç kësaj, komiteti këshillon Kuvendin Komunal për politikat dhe strategjitë e përbashkëta, veçmas sa u përket çështjeve që kanë të bëjnë me administrimin financiar dhe drejtimin strategjik të komunës.

²⁹ Neni 22 i Rregullores së UNMIK-ut 2007/30.

Ky komitet duhet të monitorojë punën e Departamentit për Financa, Ekonomi e Zhvillim, në çështjet si vendosja e buxhetit komunal, hartimi i raportit financiar vjetor, raportet e Auditorit të Përgjithshëm, alokimi i stafit për secilin departament komunal, bashkëpunimi ndër-komunal, dhe menaxhimi i ndërmarrjeve komunale.

Komiteti për Politika e Financa përbëhet vetëm nga anëtarët e Kuvendit Komunal. Pasi që ka një rol aq mbizotërues në procesin e vendimmarrjes së Kuvendit Komunal, përbërja e tij duhet të pasqyrojë vet përbërjen e Kuvendit Komunal. Në këtë kuptim, anëtarësia e komitetit duhet të pasqyrojë përpjesëtimin e ulëseve që mbahen nga partitë politike të ndryshme në Kuvendin Komunal. Për shembull, partia që ka 60% të ulëseve në Kuvendin Komunal nuk duhet të ketë më tepër se 60% të anëtarësisë së komitetit. Duhet vërejtur që kryesuesit e komiteteve të tjera kanë të drejtë të marrin pjesë në takimet e Komitetit për Politika e Financa, në pajtim me rregulloren e UNMIK-ut 2007/30³⁰.

3.2.1.2.3 Komiteti për Komunitete dhe Komiteti për Ndërmjetësim

Sipas Rregullores së UNMIK-ut 2007/30³¹, Urdhëresës Administrative të UNMIK-ut 2003/002³² dhe Udhëzimit Administrativ të MAPL-së 2005/001³³, Komiteti për Komunitete dhe Komiteti për Ndërmjetësim formojnë mekanizmin për mbrojtje të komuniteteve, për t'i siguruar secilit anëtar të cilitdo komuniteti pakicë të drejtën për të ngritur ankesa për diskriminim të ushtruar nga komuniteti shumicë apo administrata komunale. Baza për diskriminim janë të gjitha ato që lidhen me gjuhën, religjionin, origjinën etnike, bashkimin me një komunitet, etj. Ky mekanizëm synon të sigurojë që të gjitha komunitetet dhe anëtarët e tyre kanë mbrojtje, mundësi dhe qasje të barabartë në shërbimet që ofrohen nga komuna. Përveç adresimit të ankesave individuale, Komiteti për Komunitete shqyrton legjislacionin komunal në aspekt të diskriminimit potencial dhe mbështetë interesat e të drejtat e komuniteteve, për të siguruar pjesëmarrjen e të gjitha komuniteteve dhe respektimin e të drejtave dhe interesave të komuniteteve.³⁴ Ky mekanizëm është i detyrueshëm për të gjitha komunat, pa marrë parasysh madhësinë e komuniteteve në komunë. Me fjalë të tjera, komuna nuk mund të pretendojë se është e përjashtuar nga krijimi i Komitetit për Komunitete për faktin që komunitetet pakicë kanë vetëm një përfaqësim marginal në territorin e saj.³⁵

Në mënyrë që të funksionojë ky mekanizëm dhe për të shmangur përkimin e përgjegjësive, është me rëndësi të veçantë qartësimi i roleve të ndryshme të Komitetit për Komunitete dhe Komitetit për Ndërmjetësim. Sipas Rregullores së UNMIK-ut 2007/30³⁶, Komiteti për Komunitet do të mbrojtë të drejtat dhe interesat e komuniteteve dhe të shoqërisë, ku diversiteti i traditave kulturore, sociale e religjioze jo vetëm tolerohet por edhe inkurajohet. Komiteti për Ndërmjetësim do të ekzaminojë të gjitha çështjet që i referohen atij nga Komiteti për Komunitete. Rrjedhimisht, duhet të kryejë hetime që janë të nevojshme për të konstatuar nëse të drejtat e komunitetit apo pjesëtarit të komunitetit janë shkelur apo do të shkeleshin, apo nëse veprimi që është apo do të ishte i dëmshëm për interesin e komunitetit është ndërmarrë apo propozuar.

³⁰ Neni 22 i Rregullores së UNMIK-ut 2007/30.

³¹ Aneksi 2.

³² Aneksi 3.

³³ Aneksi 4.

³⁴ Neni 23 i Rregullores së UNMIK-ut 2007/30.

³⁵ Neni 21.1 i Rregullores së UNMIK-ut 2007/30..

³⁶ Neni 23.4 i Rregullores së UNMIK-ut 2007/30

Detyrat dhe përgjegjësitë e Komitetit për Komunitete janë definuar me Udhëzimin Administrativ të UNMIK-ut 2003/002 për Udhëzuesin Procedural për punën e Komitetit Komunal për Komunitete. Megjithatë, për të theksuar rëndësinë e punës së këtij komiteti dhe për të përmirësuar funksionimin e këtyre komiteteve, një listë e hollësishme e detyrave të tij është prezantuar si më poshtë:

1. Rishikimi i Rregulloreve Komunale dhe Vendime Komunale:

- Pjesëmarrja në hartimin e akteve komunale, për të siguruar pajtueshmërinë me parimet bazë të të drejtave të njeriut dhe në veçanti të drejtave të komuniteteve;
- Rishikimi i rregulloreve ekzistuese komunale dhe projekt rregulloreve në dritën e diskriminimit të mundshëm apo ndikimit negativ në një apo më tepër komunitete;
- Rishikimi i projekt rregulloreve komunale me qëllim të sigurimit që të drejtat dhe interesat e komuniteteve janë adresuar në mënyrë adekuate;
- Përgatitja dhe procedimi i rekomandimeve/opinioneve për rregulloret komunale, së pari për Komitetin për Politika e Financa dhe – në rast të mospërfshirjes – për Kuvendin Komunal.

2. Përkrahja e të drejtave dhe interesave të të gjitha Komuniteteve:

- Monitorimi i nivelit të punësimit të pakicave në komunë dhe rekomandimi i masave për përmirësime;
- Rekomandimi i masave për eliminimin e diskriminimit ekzistues apo atij potencial në ofrimin e shërbimeve komunale;
- Rishikimi i politikës për përdorim të gjuhëve që ndiqet komuna;
- Monitorimi dhe mbikëqyrja e alokimit të drejtë dhe korrekt të përbërësve të Ndarjes së Drejtë të Financimit, duke shqyrtuar Raportin tremujor për ndarjen e drejtë të financimit;
- Rekomandimi i projekteve në kuadër të Ndarjes së Drejtë të Financimit, që shkojnë në dobi të komuniteteve pakicë;
- Shqyrtimi i raportit mujor me shkrim të Zyrës komunale për komunitetet, përfshirë këtu informatat për shpenzimet e Ndarjes së Drejtë të Financimit.

2.a Aktivitetet jashtë zyrës:

- Zhvillimi i vizitave të rregullta në terren dhe raportimi më pas para tërë Komitetit për Komunitete;
- Krijimi i lidhjeve me mediat lokale për të arritur tek të gjitha komunitetet dhe për të ngritur ndërgjegjësimin për mandatin dhe funksionin e Komitetit për Komunitete.

2.b Bashkëpunimi me partnerët tjerë kyç:

- Thirrja për Koordinatorin për Standarde që të prezantojë Raportin tremujor komunal për standardet;
- Kërkesa për raportime nga departamentet e ndryshme komunale, sipas nevojës;
- Bashkëpunimi me Këshillat lokale të sigurisë publike;
- Sigurimi i përfaqësimit të drejtë të të gjitha komuniteteve në Këshillin komunal për sigurinë e komuniteteve;
- Bashkëpunimi me Zyrtarin komunal për kthim.

3. Zgjidhja e konflikteve bazuar në shkeljen e mundshme të të drejtave:

- Shqyrtimi i të gjitha ankesave në mënyrë konfidenciale dhe vlerësimi nëse ka nevojë për angazhimin e Komitetit për Ndërmjetësim;
- Referimi i të gjitha rasteve – në të cilat Komiteti për Komunitete konstaton që ka pasur shkelje të të drejtave – në Komitetin për Ndërmjetësim.

Përbërja e Komitetit për Komunitete duhet të rregullohet me Statut, në pajtim me Rregulloren e UNMIK-ut 2007/30³⁷. Anëtarësia e Komitetit për Komunitete duhet të pasqyrojë popullsinë në komunë dhe komunitetet e saj. Secili komunitet në komunë duhet të përfaqësohet nga të paktën një anëtar, duke marrë parasysh që Komiteti për Komunitete mund të ketë në përbërjen e tij edhe anëtarë që nuk janë pjesë e Kuvendit Komunal. Për të përmbushur përgjegjësitë e Komitetit, është i këshillueshëm emërimi i juristëve dhe ekspertëve me përvojë fundamentale në fushën e mbrojtjes së komuniteteve. Veç kësaj, pjesëmarrja e komunitetit shumicë duhet të jetë më pak se gjysma e përbërjes së Komitetit për Komunitete.³⁸ Përbërja e këtij komiteti është një përjashtim nga rregulli që vlen përgjithësisht për anëtarësinë e komiteteve, që duhet të pasqyrojnë përpjesëtimin e ulëseve që mbahen nga partitë politike në Kuvendin Komunal. Në takimin e tij të parë, Komiteti për Komunitete zgjedh si kryesues një nga anëtarët e tij që përfaqëson komunitetin pakicë në komunë dhe cilindo nga anëtarët tjerë si nën-kryesues të komitetit.

Në mënyrë që t'u ofrohet një mbrojtje adekuatë komuniteteve pakicë, një shumë e caktuar e shpenzimeve duhet të ju alokohen komuniteteve pakicë në çdo komunë në bazë të sistemit të Ndarjes së Drejtë Financiare. Proporcioni i Ndarjes së Drejtë Financiare është përcaktuar së pari herë me Rregulloren e UNMIK-ut 2002/23 me aprovimin e buxhetit të konsoliduar të Kosovës dhe duke autorizuar shpenzime për periudhën 1 Janar-31 Djetor të vitit 2003. Seksioni 3 i kësaj Rregulloreje thekson se “çdo komunë e cekur në tabelën 3, duhet të alokoj/ndajë për komunitetet jo shumicë në komunë, nga të hyrat e saja vetanake, Grantet e Përgjithshme të Shëndetësisë dhe Arsimit të marrë nga Buxheti i Konsoliduar i Kosovës së paku aq sa është e paraparë në tabelën 3, tabelë kjo e cila mund të rishikohet në mënyre periodike për të reflektuar lëvizjet e të personave të zhvendosur dhe/apo personave të kthyer.” Nëse komunat nuk ndajnë proporcionet apo nuk e përfillin këtë pjesë të legjislacionit, ato mund të sanksionohen. Të njejtat provizione janë përdorur edhe në Rregulloret pasuese të buxheteve vjetore.

Rregullat e procedurës duhet të specifikojnë hapat e procedurës që do të përdoren në hetimin e diskriminimit të pretenduar dhe të përcaktojnë personin që do ta zhvillojë një hetim të tillë. Veç kësaj, duhet të rregullohet mënyra e bashkëpunimit të Komitetit për Komunitete me OJQ-të në fushën e tyre të përgjegjësisë, dhe caktimi i resurseve financiare specifike për përgjegjësitë specifike.

Komiteti për Ndërmjetësim ndërmjetëson në çështjet që i referohen atij nga Komiteti për Komunitete, kur ky i fundit konsideron që veprimi i ndërmarrë apo që do të ndërmerret nga komuna ka shkaktuar shkeljen e të drejtave të komunitetit apo të një pjesëtari të tij.³⁹ Ai nuk ka autorizimin për të adresuar me vetë-iniciativë, situatat që nuk adresohen nga Komiteti për Komunitete.⁴⁰ Është i kufizuar në ndërmjetësimin për komunitetet dhe i ndalohet ndërmjetësimi komercial apo privat. Pas mbarimit të ndërmjetësimit, qoftë ky i suksesshëm ose jo, Komiteti i dorëzon raportin Kuvendit Komunal, me rekomandimin për mënyrën e trajtimit të çështjes.

Sipas Rregullores së UNMIK-ut 2007/30⁴¹ përbërja e Komitetit për Ndërmjetësim duhet të rregullohet me Statut, për të siguruar pavarësinë dhe lirinë e opinionit të anëtarëve. Komiteti për Ndërmjetësim përbëhet në mënyrë të barabartë nga anëtarët prej dy origjinave të ndryshme,

³⁷ Neni 23.2 i Rregullores së UNMIK-ut 2007/30.

³⁸ Neni 23.2 (c) i Rregullores së UNMIK-ut 2007/30.

³⁹ Neni 23 i Rregullores së UNMIK-ut 2007/30.

⁴⁰ Neni 23 i Rregullores së UNMIK-ut 2007/30.

⁴¹ Neni 23.2 i Rregullores së UNMIK-ut 2007/30

d.m.th. anëtarët nga Kuvendi Komunal, që nuk janë anëtarë të Komitetit të Komuniteteve, dhe përfaqësuesit e komuniteteve të tjera përveç nga komuniteti shumicë.

Rekomandimet:

- Statutet duhet të rregullojnë përbërjen e Komitetit për Komunitete dhe Komitetit për Ndërmjetësim, për të siguruar pavarësinë dhe lirinë e opinionit të anëtarëve.
- Kuvendi Komunal të sigurojë themelimin dhe funksionimin e duhur të Komitetit për Komunitete dhe Komitetit për Ndërmjetësim.
- Komitetit të Komuniteteve duhet dhënë një rol i veçantë i mbikëqyrjes mbi Zyrën për Komunitete, për të siguruar që paratë e pranuar nga kjo e fundit do të shpenzohen në detyrat specifike për komunitetet, apo për të siguruar buxhet shtesë për trajnimin e anëtarëve dhe për pajisjet e zyrës.

3.2.1.2.4 Komiteti për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale

Komiteti për Shëndetësi e Mirëqenie Sociale është përgjegjës për fushat që lidhen me kujdesin shëndetësor primar dhe, në kuadër të bashkëpunimit ndër-komunal, kujdesin shëndetësor sekondar. Kjo përfshin gjithashtu themelimin dhe operimin e enteve mjekësore, varrezave, krematoriumeve dhe shërbimeve të varrimit. Veç kësaj, Komiteti është përgjegjës për stabilimentet që lidhen me ujin e pijes, kanalizimin, trajtimin e ujërave, drenazhin, si dhe grumbullimin dhe hedhjen e mbeturinave; përkrahjen për shërbimet sociale dhe banimin; dhe për themelimin dhe operimin e enteve të mirëqenies sociale, përfshirë këtu jetimoret, shtëpitë për personat e moshuar dhe ata me paaftësi, strehimoret për të pastrehët dhe entet për kujdesin e fëmijëve. Në fakt, ky komitet këshillon Kuvendin Komunal në çështjet që kanë të bëjnë me shëndetësinë dhe mirëqenien sociale, dhe monitoron punën e Departamentit të Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale në çështjet që lidhen me politikat shëndetësore e sociale në komunë, dhe bën rekomandime në pajtim me kornizën e re legjislativë.

Statuti do të definojë përbërjen e Komitetit. Ai duhet të përbëhet nga një grup specialistësh me detyrë për hartimin e mëtejme dhe bërjen e komenteve për legjislacionin e iniciuar nga organet ekzekutive të komunave. Për këtë qëllim, ata mund të kooptojnë anëtarë që nuk janë anëtarë të Kuvendit Komunal, duke pasur parasysh që shumica e anëtarëve të tyre duhet të jenë gjithnjë anëtarë të Kuvendit Komunal. Komiteti dhe anëtarësia e tij duhet të pasqyrojë sa më ngushtë që është e mundur përpjesëtimin e ulëseve që mbahen nga partitë politike në Kuvendin Komunal. Kjo duhet të përcaktohet më hollësisht në Statutet Komunale.

3.2.1.2.5 Komiteti për Edukim e Kulturë

Komiteti për Edukim e Kulturë është përgjegjës veçmas për fushat që kanë të bëjnë me edukimin parashkollor, fillor, të mesëm dhe kopshtet e fëmijëve; themelimin dhe operimin e institucioneve mësimore; punësimin e stafit mësimdhënës; themelimin dhe operimin e objekteve në fushën e sportit dhe kulturës, sikur që janë teatrot, bibliotekat, kinematë komunale dhe stadiumet sportive; dhe organizimin e ngjarjeve kulturore dhe sportive. Në fakt, ky komitet

duhet të monitorojë punën e Departamentit të Edukimit dhe Kulturës në çështjet që kanë të bëjnë me politikën edukative e kulturore të komunës dhe të bëjë rekomandime në përputhje me kornizën e re legjislative.

Statuti do të definojë përbërjen e Komitetit. Këto komitete do të përbëhen nga një grup specialistësh me detyrë për hartimin e mëtejshëm dhe bërjen e komenteve për legjislacionin e iniciuar nga organet ekzekutive të komunave. Për këtë qëllim, ata mund të kooptojnë anëtarë që nuk janë anëtarë të Kuvendit Komunal, duke pasur parasysh që shumica e anëtarëve të tyre duhet të jenë gjithnjë anëtarë të Kuvendit Komunal. Anëtarësia e këtij komiteti duhet të pasqyrojë sa më ngushtë që është e mundur përpjesëtimin e ulëseve që mbahen nga partitë politike në Kuvendin Komunal.

3.2.1.2.6 Komiteti për Zhvillim Ekonomik

Komiteti për Zhvillim Ekonomik është përgjegjës veçmas për fushat që kanë të bëjnë me përkrahjen e zhvillimit ekonomik të komunës, përfshirë këtu organizimin e panairëve të tregtisë dhe tregjeve; përkrahjen e komunës për tërheqjen e biznesit dhe turizmit; bashkëpunimin me bizneset lokale apo të përfaqësuara në nivel lokal.

Statuti do të definojë përbërjen e Komitetit. Ky komitet do të përbëhet nga një grup specialistësh me detyrë për hartimin e mëtejshëm dhe bërjen e komenteve për legjislacionin e iniciuar nga organet ekzekutive të komunave. Për këtë qëllim, ata mund të kooptojnë anëtarë që nuk janë anëtarë të Kuvendit Komunal, duke pasur parasysh që shumica e anëtarëve të tyre duhet të jenë gjithnjë anëtarë të Kuvendit Komunal. Anëtarësia e këtij komiteti duhet të pasqyrojë sa më ngushtë që është e mundur përpjesëtimin e ulëseve që mbahen nga partitë politike në Kuvendin Komunal.

3.2.1.2.7 Komiteti për Planifikim Urban, Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit

Brenda kornizës së Planit Hapësinor të Kosovës dhe Planeve hapësinore për zonat e veçanta, Komiteti për Planifikim Urban, Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit, është përgjegjës për planet hapësinore të përgjithshme dhe specifike për zonat urbane dhe rurale, përfshirë këtu çështjet që lidhen me banimin; ndërtesat publike; turizmin; mbrojtjen e mjedisit; zonat për shfrytëzim publik sikur që janë parqet, fushat e gjelbra dhe hapësirat rekreative dhe sheshet e lojërave; dhe transportin publik. Veç kësaj, komiteti e ndihmon Kuvendin Komunal në miratimin e rregulloreve për këto fusha: lëvizjet e trafikut; parkimi; ndërtimi; lëshimi i lejeve ndërtimore; standardet e mirëmbajtjes për rrugët komunale dhe vendkalimet për këmbësorë; identifikimi i veçorive të interesit natyror, historik e mjedisor, përfshirë këtu mbrojtjen e tyre; emërimi i rrugëve komunale, dhe vendeve të tjera publike; dhe masat zbatuese ndaj mospajtueshmërisë. Në fakt, ky komitet duhet të monitorojë punën e Departamentit për Planifikim Urban, Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit në çështjet që kanë të bëjnë me shfrytëzimin e tokës dhe politikën mjedisore në komunë, dhe të bëjë rekomandime në përputhje me kornizën e re legjislative.

Statuti do të definojë përbërjen e Komitetit. Ky komitet do të përbëhet nga një grup specialistësh me detyrë për hartimin e mëtejshëm dhe bërjen e komenteve për legjislacionin e iniciuar nga organet ekzekutive të komunave. Për këtë qëllim, ata mund të kooptojnë anëtarë që nuk janë anëtarë të Kuvendit Komunal, duke pasur parasysh që shumica e anëtarëve të tyre duhet të jenë gjithnjë anëtarë të Kuvendit Komunal. Anëtarësia e këtij komiteti duhet të

pasqyrojë sa më ngushtë që është e mundur përpjesëtimin e ulëseve që mbahen nga partitë politike në Kuvendin Komunal.

3.2.1.3 Komitetet shtesë

Me Rregulloren e UNMIK-ut 2007/30, Kuvendit Komunal i ipet e drejta për krijim të komiteteve të tjera të përhershme dhe komiteteve me mandat të përkohshëm, nëse konsiderohet e nevojshme dhe e përshtatshme. Megjithatë, Kuvendi Komunal nuk duhet të delegojë kompetencat që janë shprehimisht të rezervuara për Kuvendin Komunal. Këto kompetenca janë për shembull: aprovimi i buxhetit komunal; caktimi i kompensimit që do t'u paguhet anëtarëve të zgjedhur; raporti vjetor; si dhe miratimi, ndryshimi apo shfuqizimi i rregulloreve komunale.⁴²

Me Statute duhet të përcaktohen komitetet e përhershme për çështjet që parashihet të jenë të rëndësishme dhe kohëzgjatjes së madhe për komunën dhe banorët. Për shembull, një komitet shtesë i përhershëm mund të diskutojë për situatën e rinisë, për zhvillimin rural, barazinë gjinore, personat me paaftësi, etj. Nevoja për të pasur komitete shtesë duhet të konstatohet duke marrë parasysh nëse personat e nominuar do të jenë në gjendje të prodhojnë inpute të rëndësishme në çështjen e dhënë, për komunën apo për Kuvendin Komunal. Kjo nuk nënkupton vetëm krijimin e komiteteve sa për të pasur organe të reja në diagramin organizativ të komunës, por do të thotë përpjekje më e madhe për artikulum të zgjidhjeve që vërtetë do të ndihmojnë administrimin e përditshëm të komunës.

Kuvendi Komunal duhet të hartojë Terme specifike të Referencës për secilin komitet të themeluar, për të specifikuar mandatin e komitetit dhe objektivat që duhet t'i planifikojë.

Përgjithësisht, komiteti i përhershëm përbëhet nga një numër anëtarësh të Kuvendit Komunal dhe nga njerëz që vijnë prej fushave të aktivitetit që është lëndë e interesit të komitetit. Me Statut rregullohet përbërja e komiteteve të ndryshme të përhershme dhe përcaktohen rregullat specifike rreth mënyrës së përzgjedhjes së secilit anëtar, dhe prej nga duhet të vijë ai/ajo. Për shembull, komiteti për aktivitetet e rinisë duhet të ketë përfaqësues të rinisë, ndërsa komiteti për zhvillim rural duhet të përbëhet nga njerëzit e sektorit në fjalë apo që kanë përvojë në atë çështje. Si rregull i përgjithshëm, përbërja duhet të pasqyrojë përpjesëtimin e ulëseve që mbahen nga secila parti politike në Kuvendin Komunal.

⁴² Neni 11.3 i Rregullores së UNMIK-ut 2007/30.

Komitetet Ad hoc themelohen për qëllime të përkohshme, sikur që është trajtimi i peticioneve nga një pjesë e popullatës për të pasur shërbime më të mira në një situatë specifike (përmirësimi i shërbimit të furnizimit me ujë në lagje apo fshatra të caktuara, ndriçimi i rrugëve apo shesheve të caktuara, etj). Statuti duhet të ketë disa rregulla të përgjithshme për themelimin e komiteteve ad hoc, sikur që është caktimi i përpjesëtimit maksimal të anëtarëve që vijnë nga jashtë Kuvendit Komunal, apo rregullat që kanë të bëjnë me përpjesëtimin e ulëseve që mbahen nga partitë politike në Kuvendin Komunal.

Rekomandimet:

- Statutet duhet të përmbajnë nene që përcaktojnë në hollësi sa komitete të detyrueshme marrin mjete për përkrahjen efektive të rolit të tyre dhe procedurave.
- Komunitat duhet të themelojnë grupin punues të përkohshëm për përpilimin e Statutit të ardhshëm të Komunës; përbërja e komitetit rekomandohet të jetë me sa vijon: anëtarët e Kuvendit Komunal, Kryetari i Komunës, Zyrtari ligjor komunal dhe anëtarët nga shoqëria civile.
- Statutet duhet të përmbajnë Terme specifike të Referencës për të gjitha komitetet komunale, duke dhënë mandate precize për secilin prej tyre, për të shmangur përkimin e aktiviteteve nga një komitet në tjetrin.
- Përveç komiteteve të detyrueshme që parashihen me ligj, komunitat duhet të krijojnë komitete, të përhershme apo të përkohshme, vetëm atëherë kur ato vërtetë nevojiten për t'i ndihmuar administrimit të komunës. Kjo duhet të përmendet në Statutet.
- Statuti duhet të ketë rregulla të përgjithshme për themelimin e komiteteve ad hoc sikur që është caktimi i përpjesëtimit maksimal të anëtarëve që vijnë nga jashtë Kuvendit Komunal, apo rregullat që kanë të bëjnë me përpjesëtimin e ulëseve që mbahen nga partitë politike në Kuvendin Komunal.
- Statuti rregullon përbërjen e komiteteve të ndryshme të përhershme dhe përcakton rregullat specifike lidhur me mënyrën e përzgjedhjes së secilit anëtar, dhe prej nga duhet të vijë ai/ajo.

3.3 Marrëdhëniet në mes të degëve të qeverisë

Karta përcakton standardet evropiane të cilat Kosova duhet të përdorë si model në administrimin e vetëqeverisjes së saj lokale. Gjithashtu, Karta specifikon që e drejta e vetëqeverisjeve lokale për rregullim dhe menaxhim të një pjese të konsiderueshme të çështjeve publike në interes të popullatës lokale “do të ushtrohet nga këshillat apo asamblatë që përbëhen nga anëtarët lirshëm të zgjedhur ... dhe që mund të posedojnë organe ekzekutive përgjegjëse para tyre.”⁴³ Karta nuk vë një metodë standarde për zgjedhjen e atyre organeve ekzekutive. Në anën tjetër, ajo njeh të drejtën e vetëqeverisjeve lokale për të “përcaktuar strukturat e tyre interne administrative me qëllim të përshtatjes së tyre për nevojat lokale dhe për të siguruar menaxhim efektiv.”⁴⁴ Kjo autonomi administrative i lejon komunës që të zgjedhë strukturën administrative më të përshtatshme për situatën e saj.

Rregullorja 2007/30 nuk është qartazi e ndarë në rregulloret për degën ekzekutive dhe legjislative. Në vend të kësaj, ajo definon përgjegjësitë e Kryetarit të Komunës në lidhje me Kuvendin në njërin anë dhe rolin e tij mbikëqyrës mbi implementimin e vendimeve dhe rregulloreve në anën tjetër.

Roli i dhënë Kryetarit të Komunës është të mbajë mbikëqyrjen mbi ekzekutimin e vendimeve të komunës dhe mbi administrimin financiar të Komunës. Në këtë drejtim, Kryetari është përgjegjës për implementimin e vendimeve dhe akteve të tjera të Kuvendit Komunal dhe për të siguruar që të gjitha përgjegjësitë dhe detyrat e komunës do të ushtrohen si duhet. Kryetari ka gjithashtu autorizimin për të përfaqësuar komunën dhe për të vepruar në emër të saj. Veç kësaj, Kryetari i Komunës është kryesues i Kuvendit Komunal dhe i kryeson takimet e Komitetit për Politika e Financa.

Pa dyshim që Kryetari i Komunës ka rol koordinues sa i përket Kuvendit Komunal, që miraton rregulloret, si dhe rol mbikëqyrës mbi Drejtorët, së këndejmi mbi shërbimin civil, që duhet të bëjë implementimin e atyre rregulloreve. Për shkak të këtij funksioni të dyfishtë, është me rëndësi të theksohen rreziqet e mundshme që mund të sjellë ky aranzhim politik, sikur që është:

- i. dobësimi i rolit të këshillit përfaqësues (dmth., Kuvendi Komunal);
- ii. polarizimi i vendimmarrjes komunale;
- iii. personalizimi i fuqisë dhe krijimi i “rrjeteve të klientëve”;
- iv. personalizimi i figurës së kryetarit të komunës apo fragmentimi i sistemit të partive politike;
- v. reduktimi i formave të mbikëqyrjes interne të administratës komunale.

Një rrezik tjetër është mundësia e ‘bashkëjetesës’ (për shembull, sistemi politik francez dhe në ShBA në nivel nacional). Kjo është situata kur votuesit zgjedhin Kryetarin e Komunës me përkatësi tjetër politike nga koalicioni shumicë në Kuvendin Komunal. Bërja e politikave në atë situatë kërkon shkathtësi të mira negocimi.

⁴³ Neni 3.2 I Kartës.

⁴⁴ Neni 6.1 I Kartës.

Me qëllim të zvogëlimit të këtyre rreziqeve, Statuti duhet të lejojë sistemin e kontrolleve reciproke në mes të përfaqësuesit (Kuvendi Komunal) dhe ekzekutivit (Kryetari i zgjedhur i komunës). Së këndejmi, Kuvendi Komunal duhet të çmojë me kujdes cilat autorizime shtesë dëshiron t'ia jap Kryetarit të Komunës. Ata duhet t'i mbajnë gjithmonë autorizimet e tyre për përcaktimin e buxhetit komunal, për caktimin e shkallëve tatimore dhe tarifave komunale, për marrjen e të gjitha vendimeve për planifikimin e përgjithshëm apo politikat që kanë ndikim në zhvillimin e komunës dhe për zgjedhjen e projekteve që ndikojnë në mirëqenien dhe të ardhmen e tërë komunës. Kuvendi Komunal do të shqyrtojë aktet administrative të Komunës. Procedurat dhe të drejtat në këtë aspekt duhet të përcaktohen në Statut, dhe në përputhje me ligjin.

Të gjitha organet komunale, veçmas Komiteti për Komunitete, duhet të inkurajojnë kulturën politike pjesëmarrëse në mesin e qytetarëve, për të rezultuar në fund me një shtresë plotësuese të kontrollit të ekzekutivit. Statuti duhet gjithashtu të ketë dispozita precize me të cilat përcaktohet roli që ka Kryetari i Komunës në mbikëqyrjen dhe kontrollimin e punës së administratës komunale.

Është me rëndësi që rolet përkatëse të Drejtorëve dhe Shefave të Departamenteve, dhe marrëdhënia në mes tyre të definojnë qartë në Statut, për të siguruar fusha të qarta të përgjegjësi dhe rrjedhimisht llogaridhënie. Po e njëjta gjë duhet bërë sa i përket Shefit të Administratës dhe Personelit që shërben si Sekretar i Kuvendit Komunal dhe i Bordit të Drejtorëve. Ai/ajo është shërbyesi më i lartë civil dhe shef i stafit për sa i përket shërbimit civil komunal. Së këndejmi, funksioni i tij/saj mund të shihet si një lidhje organizative në mes të degës ekzekutive dhe administratës së saj. Statuti duhet të bëjë përpjekje të veçantë për definimin e raportit në mes të tij/saj dhe Kryetarit të Komunës, si dhe të rolit të tij si lidhje në mes të Kuvendit Komunal dhe Kryetarit të Komunës.

Rekomandimet:

- Statuti duhet të ketë dispozita precize për rolin e Kryetarit të Komunës për të siguruar mbikëqyrjen dhe kontrollin nga ana e tij të administratës komunale.
- Statuti duhet të përcaktojë mënyrën e komunikimit të Kryetarit të Komunës me departamentet komunale dhe të punësuarit aty.

KAPITULLI IV. NËN-NIVELET KOMUNALE

4.1 Nën-nivelet komunale

Karta përcakton standardet evropiane të cilat Kosova duhet të përdorë si model në administrimin e vetëqeverisjes së saj lokale. Ajo gjithashtu themelon parimin e subsidiaritetit duke deklaruar që “përgjegjësitë publike përgjithësisht ushtrohen nga ato autoritete që janë më afër qytetarit.”⁴⁵ Sipas Kartës, autoritetet lokale përgjithësisht kanë përgjegjësinë për sigurimin e administratës që është efektive dhe afër me qytetarët.

Rregullorja e UNMIK-ut 2007/30 përcakton që secila komunë do të bëjë aranzhime me fshatrat, vendbanimet dhe lagjet urbane brenda territorit të saj, për të siguruar plotësimin e nevojave të të gjithë banorëve të komunës.⁴⁶ Me aprovimin e Kuvendit Komunal, fshatrat, vendbanimet dhe lagjet urbane mund t’i ushtrojnë aktivitetet e tyre që janë në kuadër të përgjegjësiave dhe kompetencave të komunës. Në këtë rast, këto njësi do të marrin resurse nga komuna që janë në përpjesëtim me këto përgjegjësi.

Në këtë mënyrë, shërbimet komunale të ofruara do të përshtaten më mirë me popullatën lokale që rrjedhimisht do të bëhen më të gatshëm të paguajnë për shërbimet publike. Veç kësaj, zyrtarët komunal do të bëhen më të përgjegjshëm para votuesve për cilësinë e shërbimeve që e ofrojnë ata.

Statuti dhe rregulloret tjera komunale do të përcaktojnë formën e bashkëpunimit dhe do të definojnë shtrirjen e punës dhe organizimin e atyre njësive.

4.2 De-koncentrimi i autoritetit komunal

Një mënyrë tjetër për komunën që të shtrihet më tej dhe të ofrojë shërbime më pranë banorëve të saj është të bëjë de-koncentrimin e shërbimeve në zyrat komunale nëpër fshatra, vendbanime dhe lagje urbane, duke krijuar në lloj të zyrës informuese dhe/apo shërbyese. Komuna mban kontrollin e plotë të secilës fushë së kompetencave të saj.

Në këtë mënyrë, banorët – veçmas ata pa mjetet e dhura të transportit – kanë qasje më të mirë në shërbimet si marrja e certifikatave të kurorëzimit dhe lindjes apo kërkesa për formularë të caktuar.

Statuti duhet të përshkruajë përgjegjësitë dhe detyrat që u caktohen këtyre zyrave, për të shmangur përkimin e funksioneve. Për ushtrimin e detyrave të tyre, këtyre zyrave duhet t’u sigurohen resurset e nevojshme njerëzore, financiare e teknike, të përcaktuara me Statut.

⁴⁵ Neni 4.3 i Kartës.

⁴⁶ Neni 5.1 i Rregullores së UNMIK-ut 2007/30.

Rekomandimi:

- Statuti duhet të ketë dispozita për organizimin, funksionet dhe financimin e cilësdo zyre komunale të vendosur në një entitet nën-komunal për ofrimin e shërbimeve për banorët.
- Statuti duhet të bëj ndarjen e kompetencave dhe përgjegjësive në mes të komunës dhe zyrës komunale të vendosur në një entitet nën-komunal, për të shmangur përkimin e funksioneve.
- Komunitat duhet të sigurojnë resurse të duhura për zyrën komunale të vendosur në entitetin nën-komunal (financiare, staf, dhe pajisje) për të siguruar një nivel të mirë të shërbimeve.

LISTA KONTROLLUESE – Për Grupin punues në Statutet Komunale

- Referohuni në ligjin e zbatueshëm për fushën e kompetencave komunale dhe përgjegjësi apo detyrave;
- Shmanguni nga riprodhimi i dispozitave të ligjit në Statut;
- Shikoni interpretimin ligjor të ligjit në Departamentin Ligjor të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal;
- Siguroni pajtueshmërinë e Statutit me ligjin dhe siguroni informatat e nevojshme nga Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal;
- Themeloni komitetet e detyrueshme që kërkohen me dispozitat për vetëqeverisjen lokale;
- Respektoni përpjesëtimin e ulëseve për partitë politike në Kuvendin Komunal për Komitetin për Politika e Financa dhe për të gjitha komitetet shtesë, përveç nëse me Statut parashihet ndryshe;
- Siguroni përfaqësuesin nga secili komunitet pakicë në Komitetin për Komunitete dhe Komitetin për Ndërmjetësim;
- Themeloni rregullat në Statut për emërimin e anëtarëve të Komitetit për Komunitete dhe Komitetit për Ndërmjetësim, që vijnë nga komunitetet pakicë dhe Kuvendi Komunal;
- Siguroni mjete reale për Komitetet e detyrueshme, për të promovuar rolin dhe procedurën e tyre para publikut;
- Qartësoni në Statut përbërjen e komiteteve shtesë të përhershme;
- Përcaktoni Termet specifike të Referencës për secilin komitet komunal;
- Në të gjitha takimet publike zyrtare, caktoni periudhën e pyetjeve dhe komenteve për qytetarët;
- Caktoni Kryesuesin e takimeve vjetore publike;
- Specifikoni që duhet mbajtur procesverbali i takimeve vjetore publike;
- Caktoni afatin e fundit kohor për dhënien e përgjigjeve nga Kuvendi Komunal për kërkesat e qytetarëve të parashtruara në takimet vjetore publike, apo peticionet e tyre;
- Specifikoni procedurën për prezantimin e peticionit(eve) nga qytetarët;

- Miratoni dispozita precize për organizimin, funksionet dhe financimin e cilitdo institucion nën-komunal, të themeluar për ofrimin e shërbimeve për banorët;
- Siguroni resurse të duhura (financiare, staf, pajisje) për cilindo institucion nën-komunal;
- Siguroni dispozitë të qartë për rolin e Kryetarit të Komunës, për mbikëqyrjen dhe kontrollin mbi administratën komunale; dhe,
- Vendosni mënyrat e komunikimit për Kryetarin e Komunës me administratën komunale.

ANEKSET

Aneksi 1: Karta Evropiane për Vetëqeverisjen Lokale

Aneksi 2: Rregullorja e UNMIK-ut 2007/30

Aneksi 3: Udhëzimi Administrativ 2003/002 për Komitetet e Komuniteteve

**Aneksi 4: Udhëzimi Administrativ i UNMIK-ut 2005/001 për
Komitetin për Ndërmjetësim**